



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 3322 prot.

Tiranë, më 23.12.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1003/1, DATË 10.07.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË  
ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASIT BLERTA  
RUÇI DHE ROLAND RUÇI”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga znj. Blerta Ruçi me nr. 1951 prot., datë 06.07.2022 dhe nr. 1951/1 prot., datë 06.07.2022, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit P.H. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 1003/1 prot., datë 10.07.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasit Blerta Ruçi dhe Roland Ruçi”, bazuar në nenin 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh”, nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë; sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Thoma Koxhaj”, Pallati- Alfa 07, Shkalla A, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

